



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Punëve të Jashtme – Ministarstvo
Inostranih Poslova – Ministry of Foreign Affairs
Akademia Diplomatike-Diplomatska Akademija–
Diplomatic Academy*



Ambasada e Francës në Kosovë

PROTOKOL MARRËVESHJE

mbi

Orët e financuara nga Ambasada e Francës në Kosovë, për semestrin vjeshtorë 2013
në dobi të diplomatëve të rinj të regjistruar në Akademinë Diplomatike të Kosovës.

Ndërmjet :

Akademisë Diplomatike të Kosovës, të përfaqësuar nga Drejtori i saj, Ambasadori Albert Prenkaj,

dhe

Ambasadës së Francës në Kosovë, të përfaqësuar nga Ambasadorja Maryse Daviet

Është rënë dakord siç vijon :

Neni 1 : Ambasada e Francës i beson Aleancës Franceze në Prishtinë hapjen e një seance të kurseve të specializuara të frëngjishtes diplomatike për një grup prej 14 diplomatësh të rinj të regjistruar në Akademinë Diplomatike.

Neni 2 : Grupi prej 14 pjesëmarrësve të përzgjedhur në mes të diplomatëve kosovarë është foruar nga propozimi i Akademisë Diplomatike të Kosovës.

Neni 3 : Seanca, tërësisht e financuar nga Ambasada e Francës do të përfshijë 2 orë të plota mësimi një herë në javë, në një periudhë kohore prej 10 javëve, nga 14 tetori deri më 20 dhjetor 2013 ose një total prej njëzet orëve.

Neni 4 : Kurset korrespondojnë me nivelin A1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane për Gjuhët (CECR), që do të thotë të nivelit fillestar.

Neni 5 : Kurset do të mbahen në ambientet e Aleancës Franceze në Prishtinë.

Neni 6 : Aleanca Franceze do të informojë pjesëmarrësit rreth materialit mësimor (manuallet, librat) të cilët duhet t'i blejnë për mbarvajtje të kursit.

Neni 7 : Studentët e regjistruar angazhohen, nën kontrollin e Akademisë Diplomatike, të jenë të pranishëm të paktën në 14 orë mësimore.

Neni 8 : Në rast se një student do të mungojë për më shumë se tri orë mësimore, për çfarëdo arsye, një njoftim me shkrim do t'i dërgohet studentit dhe Akademisë Diplomatike. Në rast të mungesës së studentit mbi gjashtë orë mësimore, Aleanca Franceze rezervon të drejtën që të anulojë regjistrimin e tij.

Neni 9 : Në fund të trajnimit, secilit pjesëmarrës do t'i jepet vërtetimi për ndjekje të kursit.

Neni 10 : Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit dhe do të skadojë në fund të seancës së kursit të vitit 2013.

Neni 11 : Kjo marrëveshje nënshkruhet në katër ekzemplarë origjinal, dy në gjuhën frënge dhe dy në gjuhën shqipe.

Prishtinë, më 8 tetor 2013

Për Ambasadën e Francës në Prishtinë



Maryse DAVIET Ambasadore e Francës
në Kosovë

Për Akademinë Diplomatike të Kosovës



Albert PRENKAJ, Drejtor